



Co-funded by the
Erasmus+ Programme
of the European Union

Project No: 586318-EPP-1-2017-1-AL-EPPKA2-CBHE-JP



Development and Implementation of Multimedia and Digital Television (DIMTV)

WP2.3 - Activity 2.3.1

Raport mbi trajnimin e stafit akademik mbi modulet

Project Duration: Oct 2017 – Oct 2020 (Extended to October 2021)

Start Date of Deliverable: May 2018

Submission Date: September 2021

Dissemination level: Department/Faculty, Regional, International

Lead organization: UL

Disclaimer: "This project has been funded with support from the European Commission. This report reflects the views only of the authors, and the Commission cannot be held responsible for any use which may be made of the information contained therein".



Tabela e përmbajtjes

Hyrje	3
Sesionet e trajnimit të lektorëve	4
Trajnimi i pare i stafit akademik i realizuar në VSB Technical University në Ostrava, në Maj të 2018.....	4
Trajnimi i dytë i lektorëve në Universitetin e Tartu, në Shtator të 2018.....	5
Trajnimi i tretë i stafit akademik i realizuar në Universitetin e Ljubljanes në Janar 2019.	8
Trajnimi i katërt i stafit akademik në Universitetin Aleksandër Moisiu në Prill të 2019.....	9
Trajnimi i pestë i organizuar tek EPOKA në Prill të 2019.....	11
Trajnimi i gjashtë në UAMD, Maj 2019.	12
Trajnimi i shtatë i organizuar në Universitetin e Prishtinës, Shtator 2019.....	13
Trajnimi i tetë i studentëve në qershor të 2021.	15
Trajnimi i nëntë i stafit akademik në qershor të 2021 në UAMD	19



Hyrje

Në kuadër të paketës së aktiviteteve 2.3, u organizuan disa sesione trajnimi të stafit akademik por dhe të studentëve, ose nëpërmjet vizitës së partnerëve Europeanë ose nëpërmjet trajnimit në ambjentet e universiteteve partnere dhe insitucioneve të edukimit dhe arsimit të lartë. Qëllimi i këtyre trajnimeve është përgatitja dhe njohuria mbi teknologjitë, trendet, software-ët e duhur dhe mjete të tjera të nevojshme për të ndihmuar stafin akademik në implementimin e moduleve përkatëse dhe mësimdhënies.

Gjatë kohëzgjatjes së projektit disa sesione trajnimi u realizuan sipas planit të paraqitur në tabelën e mëposhtme:

Institucioni	Vendodhja	Data
VSB Technical University	Ostrava, Czech Republic	May 2018
Tartu University	Tartu, Estonia	September 2018
University of Ljubljana	Ljubljana, Slovenia	January 2019
UAMD	Durres, Albania	April 2019
EPOKA	Tirana, Albania	April 2019
UAMD	Durres, Albania	May 2019
UP and UBT	Pristhina, Kosovo	September 2019
UAMD	Durres, Albania	June 2021
UAMD	Durres, Albania	September 2021



Sesionet e trajnimit të lektorëve

Trajnimi i pare i stafit akademik i realizuar në VSB Technical University në Ostrava, në Maj të 2018.

Sesioni i parë i trajnimit të stafit akademik u realizua në kuader të vizitës në partnerët Europianë në Universitetin Teknik të Ostravës, në Ceki. Ky trajnim u realizua nga Dr. Premysl Mer i cili prezantoi teknologjitë dhe metodat e përdorura për multimedien, të fokusuar në realizimin e përmbajtjes dhe përpunimin e tyre. Ai shpjegoi mjetet dhe teknikat që përdorin në këtë universitet për të realizuar praktikat mësimore përgjatë orëve të mësimet.

Trajnimi i dytë u realizua nga Dr. Pavol Partila, i cili prezantoi metodat dhe aplikimet e ndryshme në fushën e përpunimit të zërit si pjesë e fushës së përpunimit të përmbajtjeve multimediale.

Trajnuesit gjithashtu prezantuan listën e kursëve që mbulojnë multimedien në departamentin e tyre. Në trajnim morën pjesë staf nga UAMD, EPOKA, UP dhe UBT, partner në projekt.

Trajnimi i dytë i lektorëve në Universitetin e Tartu, në Shtator të 2018.

Vizita e dytë në partnerët europianë, u organizua në ambjetet e universitetit të Tartu, Instituti teknologjik në Tartu, Estoni. Trajnimi filloi me prezantimin e kryer nga Egils Avots, nga ky institucion, mbi teknologjitë dhe metodat e përdorur për vizionin kompjuterik si pjesë e qasjeve për përpunimin e përmbajtjeve multimediale. Ai shpjegoi teknikat e zhvillimit të bazave të të dhënave të imazheve, krijimin e modelve 3D si dhe sfidat dhe mundësitë në këtë fushë.

Sesioni i dytë i trajnimit u realizua nga prof. Dr. Gholamreza Anbarjafari nga Universiteti i Tartu, i cili shpjegoi bazat e perceptimit të vizionit kompjuterik, sfidat e përmbledhjes së të dhënave nga një kamerë e vetme për krijimin e objekteve 3D, rëndësinë e kontekstit në përpunimin e imazhit dhe tema të tjera të lidhura me përpunimin e imazhit.

Sesioni i tretë i trajnimit u drejtua nga anëtarë të Universitetit të Tartu, i cili diskutoi në lidhje me realitetin virtual dhe të shtuar. Ai prezanoi pajisjet dhe teknologjitë e nevojshme, si dhe disa raste studimi në edukim. Parimet e krijimit të përmbajtjes së realiteti virtual dhe të shtuar u prezantuan duke demonstruar disa raste studimi nga fusha e mekatronikës.

Në trajnim morën pjesë, staf akademik nga institucionet partnere të projektit si UAMD, EPOKA, UP dhe UBT.



Figure 1: Sesioni I trajnimit të lektorëve mbi teknologjitë VR dhe AR



Figure 2: Demonstrim i pajisjeve VR



Figure 3: Demonstrim i pajisjeve VR



Figure 4: Sesion trajnimi përpunim imazhi



Trajnimi i tretë i stafit akademik i realizuar në Universitetin e Ljublanës në Janar 2019.

Sesioni i tretë i trajnimit të stafit akademik, u organizua në Universitetin e Lubjanës, në Slloveni. Klemen Pečnik dhe Žana Juvan, po nga ky institucion, prezantuan në trajnim mjetin e animimit dhe modelimit Blender me një focus mbi ambientin, ndërfaqen, mjetet dhe qasjet bazike mbi modelimin. Më pas në këtë trajnim u fol mbi krijimin dhe modelimin e formave, meshing, UP mapping dhe teksturës.

Assoc. prof. Dr. Matija Marolt nga universiteti i Lubjanës ishte përgjegjës për pjesën e dytë të sesionit, i cili prezantoi bazat e rigging dhe keyframing.

Pjesa e tretë e trajnimit u realizua nga Klemen Pečnik dhe Žana Juvan. Gjatë kësaj pjese një workshop praktik u realizua mbi keyframing dhe animimin, që përfundoi me animin e karaktereve shtesë të krijuara. Në trajnim morën pjesë staf akademik nga EPOKA, UAMD, UP dhe partnerët nga UBT.





Figure 5: Trajnim mbi animim dhe modelim



Trajnimi i katërt i stafit akademik në Universitetin Aleksandër Moisiu në Prill të 2019.

Trajnimi i katërt i stafit akademik u organizua në ambjentet e UAMD, dhe në të morën pjesë gjithashtu student nga UAMD. Tema e trajnimit përfshinte animin në Blender për modelimin 3D. Gjatë trajnimit, trajnuesit Klemen Pečnik dhe Žana Juvan vazhduan sesionet e trajnimit në modelimin e karaktereve dhe lëvizjeve të tyre. Audiencia ndiqi hap pas hapi shembuj të ndryshëm, duke ju mundësuar atyre njohurinë nëpërmjet praktikës. Trajnuesit përgatitën projekte individuale ku mund të punohej lehtësisht me qëllimin e vetëm për të kuptuar më mirë parimet e animimit të aplikuara në lëvizjen e karaktereve. Ata përdorën karaktere të segmentuar për të mësuar konceptet e balancës, peshës, qendrës së gravitetit, pozicionit, veprimet e motivuara, veprimet sekondare, reagimet, siluetat. Audiencia mësoi të përgatisë karaktere me më shumë peshë, qëndrueshmëri, më të pavarur në skenarë të ndryshëm të veprimeve.

Një session shtesë mbi editimin video u prezantua nga të njëjtët lektorë.

Trajnimi u ndoq nga studentët dhe stafi akademik i UAMD.

Një video prezantuese e shkurtët mund të gjendet tek linku i mëposhtëm:
<https://www.youtube.com/watch?v=j5AB54RpV04>



Figure 6: Workshop animim dhe modelim në Durres



Figure 7: Workshop animim dhe modelim në Durrës




Figure 8: Workshop animim dhe modelim në Durrës



Trajnimi i pestë i organizuar tek EPOKA në Prill të 2019.

Sesioni i 5 -të i trajnimit të stafit akademik mori pjesë në universitetin EPOKA ku morën pjesë stafi akademik dhe studentë nga departamentet e Inxhinierisë Kompjuterike dhe Arkitekturës. Tema kryesore e trajnimit ishte Modelimi dhe Animimi 3D duke përdorur softuerin Blender. Trajnimi u mbajt nga Klemen Pečnik dhe Žana Juvan nga Universiteti i Lubjanës. Temat e trajnimit konsistojnë në modelimin 3D, manipulimin, inkuadrimin e çelësave dhe animacionin. Trajnimi u organizua përmes prezantimeve ndërvepruese në Poërpoinit, shumë projekte praktike, diskutime dhe sesione të pyetjeve dhe përgjigjeve.

Trajnimi u ndoq nga studentët dhe stafi mësimdhënës nga Universiteti EPOKA.




Figure 10: Broshura mbi animimin dhe modelimin



Figure 9: Training session on modeling and animation



Trajnimi i gjashtë në UAMD, Maj 2019.

Fokusi i trajnimit të 6-të ishin animacioni dhe aspektet pas prodhimit. Në kuadër të trajnimit të mëparshëm në Prill 2019 për stafin akademik (dhe studentët), i cili i ndihmoi ata të mësonin temat kryesore mbi animacionin 3D dhe post-produksionin, pjesëmarrësve iu dhanë detyra shtëpie dhe projekte praktike në zgjidhjet softuerike Blender dhe After Effects. Në këtë sesion trajnimi, pjesëmarrësit kanë prezantuar projektet e tyre të animacionit dhe post-prodhimit, të cilat u komentuan, u shpjeguan dhe u optimizuan. Dilemat dhe pyetjet u përgjigjën nga mbikëqyrësit e sesionit të trajnimit Klemen Pečnik dhe Žana Juvan nga Universiteti I Lubjanës. Sesioni kishte një ndikim të rëndësishëm në kuptimin e aspekteve të animacionit dhe pasprodhimit.



Figure 11: Pajisjet e transmetimit



Trajnimi i shtatë i organizuar në Universitetin e Prishtinës, Shtator 2019.

Sesioni i shtatë i trajnimit të mësuesve u zhvillua në Prishtinë në institucionet partnere të UP dhe UBT dhe zgjati tre ditë. Temat kryesore ishin animacioni, modelimi 3D dhe post-produksioni i videos. Sesionet u udhëhoqën nga Klemen Pečnik dhe Žana Juvan nga Universiteti i Lubjanës.

Dita e parë përfshiu tema të animacionit dhe modelimit 3D duke përdorur Blender, ku temat kryesore përfshinin përfundimin e modeleve, dritave dhe kamerës dhe manipulimin.

Dita e dytë u nda në dy pjesë. Pjesa e parë përfshinte vazhdimin e temave të ditës së parë, ndërsa pjesa e dytë u zhvillua në ambientet e UBT -së në Prishtinë, ku u zhvillua punëtori praktike e xhirimit të videove.

Tema kryesore nëse trajnimi i ditës së tretë ishte video post-produksioni, me tema si hyrje në redaktimin e videos, afatin kohor dhe mjetet, korigjimin e ngjyrave, redaktimin e zërit, vlerësimin e ngjyrave, tekstin dhe eksportimin.

Trajnimi u ndoq nga stafi mësimdhënës nga institucionet partnere të UP dhe UBT.



Figure 12: Trajnim mbi animim dhe modelim 3D në UP




Figure 13: Shembuj animim dhe modelim 3D



Figure 14: Pajisje të prodhimit të videos UBT



Trajnimi i tetë i studentëve në qershor të 2021.

Sesioni i tetë i trajnimit të stafit akademik dhe studentëve u zhvillua në Durrës në institucionin partner të UAMD dhe zgjati për tre ditë. Temat kryesore ishin animimi me modelimin 3D si vazhdim i trajnimeve të mëparshme dhe prodhimit të videove. Sesionet u udhëhoqën nga Klemen Pečnik dhe Žana Juvan nga Universiteti i Lubjanës

Si pjesë e trajnimit, u mbajtë ëorkshop në fushën e modelimit dhe animacionit në programin Blender, ku studentët dhe mësuesit pjesëmarrës mësuan se si të bëjnë modele 3D, tekstura të përshtatshme, të animojnë lëvizjet e tyre dhe të eksportojnë në videot përfundimtare. Në pjesën e dytë të trajnimit, u mbajtën ëorkshop në fushën e prodhimit të AV, ku studentët, duke përdorur pajisjet e fituara në kuadër të projektit DiMTV, krijuan një studio për të regjistruar intervista dhe për të mësuar përdorimin e pajisjeve multimediale në shembuj praktikë. Pjesëmarrësit e seminarit e testuan veten në role të ndryshme që janë pjesë e fazave të ndryshme të prodhimit të AV.



Figure 15: Shembull modeli 3D I krijuar në workshop



Figure 16: Klemen Pečnik nga UL në workshop mbi modelimin 3D




Figure 17: Mentorim gjatë workshop



Figure 18: Përgatitja e pajisjeve dhe studios në workshop



Figure 19: Leksion mbi post produktionin Video në workshop



Trajnimi i nëntë i stafit akademik në qershor të 2021 në UAMD

Trajnimi i fundit i stafit akademik u organizua nga ekspertët nga universiteti i Lubjanës, Klemen Pečnik dhe Žana Juvan. Dita e parë e trajnimit u realizua në formën e një diskutimi të hapur, ku secili prej lektorëve pjesëmarrës diskutuan mbi sfidat gjatë mësimdhënies online, dhe përdorimit të teknologjive më të fundit multimediale si dhe propozimin apo sugjerimin e zgjidhjeve optimale.

Gjatë ditës së dytë, fokusi u zhvendos në teknologjitë e avancuara inxhinjerike në television, zgjidhjet hibride dhe arkitekturat e së ardhmes, si dhe pajisjet audio.

Në ditën e tretë të trajnimit, stafi u njoh me zgjidhjet praktike duke shfrytëzuar pajisjet e studios multimediale në UAMD. Ndërtimi i sistemeve të transmetimit live dhe përditësimi i tyre ishin fokusi kryesor.



Figure 20: Dita e parë e stafit akademik nga ekspertët nga Universiteti i Lubjanës



Figure 21: Dita e tretë e stafit akademik nga ekspertët nga Universiteti i Lubjanës